



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

ZYRA E RINDERTIMIT

Nr. 2702 Prot.

Vorë, më 12.05.2023

Lënda: Njoftim për zhvillimin e shortit publik për përfitim të apartamenteve në pallatet e rindërtuara në Fshatin “Marikaj”, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019.

Bazuar në Ligj Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Neni 162 Njoftimi publik, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar dhe Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.19, datë 07.03.2023 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të shorteut publik për ndarjen e njësisive të banimit në objektet e reja (pallatet) të rindërtuara për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019”, (pallatet) në Fshatin Marikaj , ju njoftojme se:

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak të shpallur përfitues në pallatet e Rindërtuara në fshatin “Marikaj”, Bashkia Vorë do të zhvillojë shorteun për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindërtuara për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019 në fshatin “Marikaj”, në datën 27.05.2023, ora 10:00, në ambientet e shkollës 9-vjecare Marikaj.

Bashkangjitur gjeni listën me emrat përfitues sipas zyrës së Rindërtimit Bashkia Vorë dhe VKB Vorë.

Njoftimi Publik do të afishohet në stendën e Bashkisë Vore dhe Faqen zyrtare të Bashkisë Vorë.

Mospjesmarrja juaj nuk pengon zhvillimin e shorteut, por ju bëjmë me dije se në rast se nuk paraqiteni në shorte, përzgjedhja për ju do të bëhet nga Kryetari i Komisionit Për Organizimin e Shortit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARI

Blerim Shera

